



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



26 - 02 - 2024

RECEIVED			
MAILED	RECORDED	RECEIVED	RECEIVED
Naziv org. Org. jedinica Org. Unit	Numb Broj Number	Snojca Prilog Appendix	Vred Vrednost Value
01	016	12618	Z

Procesverbali nga mbajtja e konsultimit publik me qytetarë për Projekt-Planin e Qëndrueshëm të Mobilitetit Urban (PQMU) të Komunës së Suharekës

Konsultimi publik me qytetarë është organizuar nga grupi punues për hartimin e Projekt-Planin e Qëndrueshëm të Mobilitetit Urban (PQMU) të Komunës së Suharekës.

Me 01.02.2024 është publikuar njoftimi për mbajtjen e Konsultimit për **Projekt-Planin e Qëndrueshëm të Mobilitetit Urban (PQMU) të Komunës së Suharekës**.

Njoftimi është publikuar në webfaqen zyrtare të Komunës, facebookun e komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike.

1. Publikimi në webfaqe: <https://kk.rks-gov.net/suhareke/wp-content/uploads/sites/30/2024/02/Njoftimi-Konsultimin-Publik-Projekt-Planin-e-Qendrushem-te-Mobilitetit-Urban.pdf>
2. Publikimi facebook:
<https://www.facebook.com/photo/?fbid=770189648475601&set=a.286786603482577>
3. Publikimi në Platformën e Konsultimeve Publike: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42275>
4. Njoftimi si lajm në webfaqe: <https://kk.rks-gov.net/suhareke/news/njoftim-per-konsultim-publik/>

Me 08.02.2024, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe: <https://kk.rks-gov.net/suhareke/news/projekt-plani-i-qendrueshem-i-mobilitetit-urban-per-komunen-e-suharekes/>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=774525141375385&set=pcb.774525284708704>

Konsultimi është mbajtur në sallën e kuvendit komunal dhe ka filluar në orën 11:00

Visar Kuqi: Të nderuar qytetarë, ju falënderoj që jeni bashkë me ne për të diskutuar për Projekt-Planin e Qëndrueshmët të Mobilitetit Urban (PQMU) të Komunës së Suharekës. Me ne është Kryetari i Komunës z. Bali Muharremaj. Kryetari pat dëshirë që të jetë para jush dhe fizikisht të bëjë fjalën përshtendetëse edhe të komunikojnë të paktën disa minuta me ju.

Ky dokumentë do të jetë në konsultim publik deri më datën 15 shkurt në orën 16.00, të gjithë qytetarët të cilët nuk kanë pasur mundësi të janë prezentë në konsultim publike për projekt-planin e qëndrueshmët të mobilitetit urban do të kenë mundësi deri më datën 15 shkurt 2024, nëse kanë ide apo sugjerime, vërejtje gjetje çfarëdo që kanë ata ti adresojnë te Drejtoria për Urbanizëm Planifikim dhe Mjedis dhe besojmë që të bëjmë më të mirën, unë nuk po zgjatem më shumë dhe po i'a kaloj fjalën te Kryetari i Komunës.

Bali Muharremaj: Pershendetje per të gjithë të pranishmit që janë këtu faleminderit për pjesëmarrje.

Ne si Komunë kemi kaluar Planin Zhvillimor komunal si dhe Hartat Zonale jemi në përfundimm të projekt planit të mobilitetit të qëndrushëm urban. Kommentet dhe sygjerimet e juaja janë shumë të rëndesishme rreth këtij plani. Falenderojmë UNDP më të cilët kemi bashkëpunim të mire edhe në projekte të tjera ju falenderoj për vëmendje edhe suksese në punë.

Visar Kuqi: në këtë projekt kanë marrë pjesë ekspertet të cilët do të bëjnë prezantimin dhe për të marrë komente, sugjerime edhe pyetje prej juve.

Mevlan Bixhaku: bashkë me ekipin bashkëpunëtor që kemi punuam në draftin final të planit mobilitetit qëndrueshmë urban do të mundohem që para jush të bëj një prezantim duke mare parasyshë se paraprakisht dokumenti ka qenë në dispozicion edhe në web faqe, për atë arsy do të mundohen vetëm të sqarohen pikat më të rëndësishme të cilat janë pjesë përbërëse e planit mirëpo edhe kuptohet në aspektin e disa nga qëllimeve dhe objektivave që janë shumë të rëndësishme për planin e mobilitetin. Është një plan strategjik e unë po përmendi përbushjen e kërkesave për një lëvizshmëri të gjithë pjesëmarrësit në trafik edhe synimi është që krijohen kushte të sigurta dhe funksionale për akomodimin e gjithë pjesëmarrësve në trafik. Plani i Mobilitetit të Qëndrueshmë Urban (PMQU) është një plan strategjik i hartuar për të plotësuar nevojat e lëvizshmërisë të njerëzve dhe bizneseve në qytete dhe rrethinë për një cilësi më të mirë të jetës. PMQU bazohet në praktikat ekzistuese të planifikimit dhe i kushton vëmendje të veçantë parimeve të: integrimit, pjesëmarrjes dhe vlerësimit. Një PMQU paraqet një grup të integruar të masave teknike, infrastrukturore, të bazuara në politika si dhe në masa të buta për të përmirësuar performancën dhe efektivitetin e kostos në lidhje me qëllimin dhe objektivat e planit strategjik.

Plani është hartuar në tri periudha afatmesme afatshkurtër dhe afatgjate, synimi jonë është bazuar në një metodologji e cila ka gjetur shumë zbatim në praktik.

Në çdo paraqitjet grafike që po i vëreni është ajo ndryshimi për 24 orë sipas numruesve automatikë që janë marrë, edhe shohim se për secilën pjesë të rrugës sesi ka ndryshuar qarkullimi ose trafiku në periudha të ndryshme kohore një ngarkesë të rrjetit rrugor.

Rruja kryesore nationale N25 (rruga "Brigada 123") është mjaft e ngarkuar me qarkullim të automjeteve. Në këtë pjesë të rrugës, brenda 24 orëve qarkullojnë rreth 18,704 aut/ditë në dy kahe Ndërsa, për të njëjtën rrugë, në dalje të qytetit (në drejtim të Prishtinës), brenda 24 orëve qarkullojnë rreth 8,784 aut/ditë. Rruja e cila shpie në drejtim të autoudhës dhe anasjelltas, gjithashtu ka një ngarkesë rreth 11,130 aut/ditë në dy kahe. Ndërsa, ngarkesë më e vogël është evidentuar në dalje të qytetit (në drejtim të Prishtinës), ku brenda 24 orëve qarkullojnë rreth 8,918 aut/ditë në dy kahe.

Pas analizës së të dhënave është konstatuar se në krahasim me muajin mars (kur janë realizuar matjet e para) në muajin gusht (kur janë realizuar matjet e dyta) në pjesën e rrugës nga autoudha në drejtim të qendrës së qytetit, fluksi i trafikut është rritur për rreth 139%, respektivisht nga 4,723 aut/ditë (në muajin mars 2023) në 11,296 aut/ditë (në muajin gusht). Ndërsa, në pikën tjeter në hyrje-dalje në drejtim të Prizrenit, fluksi i trafikut është rritur për rreth 39%, respektivisht nga 9,920 aut/ditë (në muajin mars 2023) në 13,787 aut/ditë (në muajin gusht), duke quar numrin e përgjithshëm në dy kahe në rreth 23,707 aut/ditë në kahet e lëvizjes.

Gzim Hoxha: Analiza infrastrukturore e zonës urbane të Suharekës, është realizuar gjithashtu përmes modelimit softuerik dhe simulativ duke inkorporuar në model të gjithë rrjetin rrugor të zonës urbane të Suharekës. Në këtë rast janë analizuar dy skenarë: Skenari 1 – Analiza e gjendjes ekzistuese të trafikut, dhe Skenari 2 -Analiza e gjendjes pas aplikimit të masave për përmirësim. Në të dy skenarët janë analizuar kapacitetet e kryqëzimeve, vonesat në operimin e trafikut, tregues tjerë që ndërlidhen me kualitetin e operimit të trafikut, tregues të ndikimit të operimit të trafikut në eficencën e shpenzimeve të karburantit si dhe tregues që ndërlidhen me ndotjen e mjedisit për shkak të vonesave apo pritjeve të gjata të krijuara në trafik.

Një nga pjesët kryesore të sistemit multimodal, të qëndrueshëm dhe të barabartë të mobilitetit është infrastruktura për bicikleta, e cila në Suharekë është zhvilluar pjesërisht përgjatë rrugës kryesore nationale N25 nëpër të cilën qarkullojnë rreth 19,000 aut/ditë. Shtegu ekzistues për çiklistë është i ndarë nga pjesa e rrugës, por janë në nivel të njëjtë me trotuarin për lëvizje të këmbësorëve. Shtegu ekzistues me gjerësi 1.0 m është i vendosur vetëm në njëren anë të rrugës dhe nuk i përbushë kriteret teknike për shtigjet e çiklistëve.

Pas analizës së gjendjes është vlerësuar se ekziston kërkësë e lartë për parkimin e automjeteve në qendër të qytetit dhe në zonat tjera më shumë të banuara. Në veçanti, kërkesa për parkim është më e madhe për vendparkimet në rrugë se sa për parkimet jashtë rrugës, ku nuk ekzistojnë kufizimet kohore.

Qyteti i Suharekës ka 43 Zona (vende për parkim) të disponueshme për parkingje ku disa zona të parkingjeve janë të dendura plotësisht ndërsa disa edhe pse në afersi të qendrës janë pothuajse të pashfrytëzuara. Pas analizës së gjendjes në terren dhe nga anketimeve, është konstatuar se në qytetin e Suharekës janë rreth 1,156 parkingje publike.

Transporti publik urban në komunën e Suharekës, sikurse u theksua edhe më parë është i organizuar vetëm në nivel urbano-periferik dhe është i varur kryesisht nga gjendja e rrjetit rrugor ekzistues. Vendqëndrimi i autobusëve në Suharekë gjendja e rrugëve nacionale dhe rajonale nuk është e kënaqshme e po ashtu edhe rrjeti lokal urban nuk e plotëson funksionin e vet themelor, përveç në disa pjesë të shkurtra. Në kuadër të hartimit të Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban për Suharekën është realizuar procesi i përgjithshëm i mbledhjes dhe vlerësimit të dhënavët e grumbulluara në hulumtimin e anketimit të ekonomive familjare sipas metodës fizike dhe asaj online. Gjatë anketimeve janë realizuar intervistimet për 34 banorë rezident në qytetin e Suharekës. Plani për mbledhjen e të dhënavët është realizuar në fillim të vitit 2023 kurse procesi i grumbullimit është realizuar në periudhën kohore Maj-Korrik 2023.

Pas analizës së gjendjes është vlerësuar se ekziston kërkësë e lartë për parkimin e automjeteve në qendër të qytetit dhe në zonat tjera më shumë të banuara. Në veçanti, kërkesa për parkim është më e madhe për vendparkimet në rrugë se sa për parkimet jashtë rrugës, ku nuk ekzistojnë kufizimet kohore.

Qyteti i Suharekës ka 43 Zona (vende për parkim) të disponueshme për parkingje ku disa zona të parkingjeve janë të dendura plotësisht ndërsa disa edhe pse në afërsi të qendrës janë pothuajse të pashfrytëzuara. Pas analizës së gjendjes në terren dhe nga anketimeve, është konstatuar se në qytetin e Suharekës janë rreth 1,156 parkingje publike.

Për të përmirësuar cilësinë e ajrit në Komunën e Suharekës, rekomandohen një numër veprimesh në lidhje me sektorin e transportit: Reduktimi i numrit të automjeteve përmes promovimit të transportit publik kundrejt transportit privat, dhe përmirësimi të menaxhimit të rrjetit rrugor, përmirësimi i transportit publik dhe promovimi i teknologjive të automjeteve të pastra, inkurajimi i çiklizmit dhe shtimi i zonave të gjelbra dhe aktivistët e mjedisit së bashku me OJQ-të dhe institucionet publike të janë vazhdimisht aktivë në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut se jetesa normale dhe e shëndetshme është e mundur vetëm përmes një mjedisi të pastër.

Në konsultim me palët e interesit të qytetit u zhvilluan tre skenarë të ndryshëm dhe u vlerësuan përfundimtarët në zhvillimin e strategjisë së preferuar të mobilitetit urban për Suharekën. Secili prej këtyre skenarëve u hartua për të arritur vizionin dhe objektivat në mënyra të ndryshme.

Skenari proaktiv thekson bashkëpunimin e mënyrave individuale të transportit me qëllim të përzgjedhjes, për secilin rast të kërkësës për transport, së mënyrës më efektive të transportit. Kjo bëhet përmes organizimit aktiv të sistemit mbështetës dhe ndikimit në përzgjedhjen e mënyrës së transportit të njerëzve. Në këtë mënyrë kontrollohet puna e përgjithshme e transportit. Qëllimi i skenarit është që të arrihet cilësi më e lartë e jetës në qytet.

Skenari liberal Skenari liberal u mundëson përdoruesve të rrugëve të përzgjedhin vetë mënyren dhe format e transporit në qytet dhe nuk ka ambicie të ndikoj në vendimin e tyre. Ky skenar nuk favorizon asnjë formë të transportit apo nuk preferon asnjë mënyrë transporti mbi të tjerat.

Qëllimi është që të sigurohet infrastrukturë sa më e mirë e mundshme për nevoja të transportit.

Skenari i mirëmbajtjes në përgjithësi nuk ndërton infrastrukturë të re. Ai trajton gjendjen e infrastrukturës ashtu siç është tani për të minimizuar rrezikun që infrastruktura e re të tërheqë më tepër vetura. Ky skenar më tepër përqendrohet në përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese dhe në mënyra më të mira për kontrollimin e trafikut.

Të gjitha palët e interesit ishin të mendimit që të merret në trajtim një skenar i cili merr parasysh zhvillimet e Suharekës dhe përshtatjen e mobilitetit urban këtyre zhvillimeve. Pra, të gjitha palët propozuan skenarin e proaktiv - Skenari i proaktiv i transportit të qëndrueshëm i cili do t'i përshtatej më së miri situatës në Suharekë.

Qëllimet e një Plani të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU) janë të ndryshme dhe nuk përqendrohen thjesht vetëm në lëvizshmëri dhe transport, por më tepër në cilësinë e jetës urbane.

Qëllimi 1 -përmirësimi dhe menaxhimi i infrastrukturës rrugore, krijimi i politikave që promovojnë menaxhimin dhe funksionimin efikas të sistemit të transportit, si dhe funksionimin efikas të transportit multimodal.

Qëllimi 2 - përmirësimi i infrastrukturës dhe rritja e sigurisë për lëvizje të kömbësorëve dhe çiklistëve Inkurajimi i njerëzve të ecin dhe të lëvizin me bicikletë, krijimi i një sistemi të integruar të rrjetit rrugor që ofron një zgjidhje të sigurt dhe funksionale të udhëtimit dhe që adreson nevojat e lëvizjeve jo motorike.

Qëllimi 3 -zhvillimi dhe përmirësimi i sistemit të Transportit Publik një rrjet i ri që mbulon tërë Suharekën dhe zonën përreth dhe që ofron shërbime të rregullta dhe të shpeshta, i mbështetur me shërbime shtesë që lidhin zonat periferike.

Qëllimi 4- zhvillimi dhe përmirësimi i sistemit të parkingjeve, menaxhimi dhe kontrolli i parkingjeve në rrugë dhe jashtë rrugës për të zvogëluar konfliktet e trafikut, pengesat dhe vonesat, duke siguruar që ka një regjim të përshtatshëm të zbatimit për të menaxhuar ofertën dhe rregulloret e parkimit në mënyrë efektive.

Qëllimi 5-përmirësimi i sigurisë dhe menaxhimi i trafikut Vendosja e kriterieve që përqendrohen në aspektin e sigurisë së projekteve dhe kërkojnë që elementi i sigurisë së projekteve të adresohet siç duhet përpara se të merret parasysh miratimi.

Qëllimi 6 -menaxhimi i mobilitetit përmes pajisjeve intelegrante - “MOBILITETI I MENÇUR” Menaxhimi i lëvizjes së sigurt, të përshtatshme dhe të arritshme të njerëzve dhe mallrave në të gjithë qytetin përmes pajisjeve intelegrante “ITS”.

Qëllimi 7-mjedis më të pastër dhe të sigurtë, sigurimi i infrastrukturës dhe shërbimeve të transporti që rrisin cilësinë e jetës, si dhe mbrojtjen e mjedisit.

Merita Koqi- komuna e Suharekës shumë shpejt do të delë me një njoftim për qytetarët rreth lokacionit të mbushësve të makinave elektrike.

Salih Elshani- ne jemi të vetëdishëm për gjendjen aktuale por cila është zgjidhja të dilet nga kjo situate.

Cilat janë rrugët alternative që do të përdoren.

Mevlan Bixhaku – dokumenti I prezantuar sot ishte në pikë të shkurta. Plani I Mobilitetit është një plan stragjeik I cili mund të ndryshohet dhe të përmirsohet.

Aida Kuqi- tek rruga Skenderbeu nuk ka ndalesa të autobuseve për këtë arsyë ka ngarkesa në trafik, a është I paraparë me këtë plan ndonjë stacion i autobuseve në ndonjë vend tjetër në qytet. Edhe te parkingjet forma e menagjimit a do të jetë publike apo do të kalojë në sektorin privat, si do të njoftohen qytetarët dhe si do të bëhen pagesat.

Mevlan Bixhaku- aplikacioni Smart do të jetë një qështje e cila do të trajtohet në vazhdim. Për vendodhjen e vendndalimit të autobuseve do të bëhet një projekti vegantë.

Refki Zogaj- sa kohë nevoitet që të implementohet ky projekt.

Mevlan Bixhaku- janë periudha të parapar – 10vjeqar është plani.

Shkelzen Sylaj- a kini planifikuar rrugë alternative në rrugen “Brigada 123”.

A do të jetë e mjaftueshme rruga dy kahëshe.

Mevlan Bixhaku- të gjitha rrugët kanë me I përbushë kërkeshat për qarkullim.

Takimi përfundoi në ora 12:15.

Procesmbajtësja

Kujtime ALIAJ